

VENDIM
Nr.24, datë 24.7.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 12.05.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqata e shoqërive të hidrokarbureve, përfaqësuar nga avokatët Thimjo Kondi, Viktor Ikonomi dhe Rigels Ikonomi me autorizim të datës 10.02.2009.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari dhe Zamir Stefani me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009 “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (dizel), të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë.”

2. Pezullimi i zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009, deri sa vendimi përfundimtar i kësaj Gjykate të hyjë në fuqi.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 131/c, 118/1, 118/2 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 45 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Admir Thanza; përfaqësuesit e Shoqatës së Shoqërive të Hidrokarbureve (kërkuesi), që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjektit të interesuar, që kërkuar rrëzimin e saj dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Me vendimin nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe dizel” (VKM nr.147) të Këshillit të Ministrave përcaktohet, ndërmjet të tjerash, se në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga data 1 janar 2009 do të lejohet, për përdorim në automjetet rrugore dhe gjeneratorët, vetëm tregtimi i lëndës djegëse dizel, që në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodin 27101941, e cila plotëson kërkesat e standardit shqiptar S SH EN 590 ose të standardeve të tjera, të barasvlefshme me të (Dizel D1). VKM nr.147 përcakton gjithashtu sasinë e lejuar të squfurit në lëndën djegëse për motorët dizel, e cila nga data 1 janar

2009 nuk lejohet të kalojë 350 mg/kg dhe nga data 1 janar 2011 nuk lejohet të kalojë 10 mg/kg.

Më tej, Këshilli i Ministrave nxori vendimin nr.1110, datë 30.07.2008 “Për cilësinë e lëndës djegëse diesel, të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, vendase”, (VKM nr.1110) me anë të së cilit lejoi një përjashtim nga VKM nr.147, përse i përket sasisë së squfurit të lejuar në lëndën djegëse Diesel D1 të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase, e cila do të tregtohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. VKM nr.1110 lejonte që lënda djegëse Diesel D1, e prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase, të tregtohej në kushte më të favorshme se ajo e importuar, për arsye se ky vendim përcaktonte se sasia e lejuar e squfurit në lëndën djegëse Diesel D1 të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto vendase, nga data 1 janar 2010 nuk lejohet të kalojë 350 mg/kg, nga data 1 janar 2011 nuk lejohet të kalojë 150 mg/kg dhe nga data 1 janar 2012 nuk lejohet të kalojë 10 mg/kg.

Autoriteti i Konkurrencës, pas ankimit të paraqitur pranë tij nga Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve, i rekomandoi Këshillit të Ministrave shfuqizimin e VKM nr.1110 pasi, sipas tij, kufizonte konkurrencën mes ndërmarrjeve që veprojnë në treg për shkak të aplikimit të kushteve të pabarabarta të tregtimit ndërmjet ndërmarrjeve, në lidhje me produktin vendas dhe atë të importit.

Pas këtij rekomandimi Këshilli i Ministrave nxorri vendimin nr.52, datë 14.01.2009 “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diesel), të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë”, i cili është objekt i këtij shqyrtimi pranë Gjykatës Kushtetuese.

Me vendimin nr.52, datë 14.01.2009 Këshilli i Ministrave shfuqizoi vendimin e tij nr.1110, datë 30.07.2008, por dispozitat e shfuqizuara të këtij të fundit u inkorporuan në pikat 6 dhe 7 të vendimit nr.52, datë 14.01.2009. Vendimi, objekt shqyrtimi, lejoi një përjashtim tjetër ndaj ndalimit të vendosur nga vendimi nr.147, datë 21.03.2007 duke lejuar tregtimin e lëndës djegëse gazoil (diesel), për automjete rrugore dhe gjeneratorë, që në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodin 27101945 dhe plotëson kërkesat e standartit S SH 31:1997 ose të standardeve të tjera, të barasvlefshme me të (Diesel D2), e cila prodhohet në rafineritë e vendit nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të shfuqizuar këtë akt si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe për të pezulluar zbatimin e tij deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duke argumentuar se akti, objekt i këtij shqyrtimi kushtetues:

- është në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës, për arsye se vendos një kufizim të lirisë ekonomike që mund të vendoset vetëm me ligj.

- është në kundërshtim me nenin 118, pika 1 dhe 2, të Kushtetutës, për arsye se është i bazuar në ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili nuk përmban asnjë delegim legjislativ në favor të Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore. Kurse, përse i përket ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, kërkuesi pretendon se vendimi objekt shqyrtimi nuk ka lidhje me delegimin legjislativ të bërë nga neni 10, pika 5 e këtij ligji;

- është i papajtueshëm me marrëveshjet ndërkombëtare OBT – GATT (Marrëveshje e Përgjithshme për Tregtinë dhe Tarifat e Organizatës Botërore të Tregtisë) dhe MSA (Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit me Bashkimin Europian), pasi lejon favorizimin e një ndërmarrjeje private me pozitë dominuese në treg për produkte që, pavarësisht nga origjina e tyre, kanë të njëjtin përdorim dhe krijojnë të njëjtat probleme për ndotjen e mjedisit;

- duhet pezulluar pasi, nëse ky vendim zbatohet, dëmtohen rëndë interesat e anëtarëve të kërkuesit, si dhe konkurrencën në treg, duke u favorizuar arbitrarisht shoqëria ARMO sh.a.

Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, parashtroi se kërkesa duhet rrëzuar pasi:

- Kërkuesi nuk legjitimohet për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për arsye se nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet lirisë ekonomike të anëtarëve të kërkuesit dhe vendimit të

kundërshtuar, sepse antikushtetutshmëria e këtij vendimi, edhe nëse pranohet, nuk ndryshon pozitën e anëtarëve të kërkuarit.

- Nuk është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese shqyrtimi i pretendimit të kërkuarit se është shkelur ligji nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi ky pretendim i përket vlerësimit të papajtueshmërisë së ligjeve me njëri-tjetrin.

- Referimi i vendimit objekt shqyrtimi te nenet 8 dhe 9 të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” mund të jetë i gabuar, por ky gabim nuk passjell antikushtetutshmërinë e tij.

- Vendimi, objekt shqyrtimi kushtetues, është nxjerrë në kuadrin e një rezerve ligjore relative që mundëson nxjerrjen e akteve nënligjore për të disiplinuar një çështje, e cila, përveçse nga ligji që cakton linjat dhe parimet themelore, duhet të disiplinohet edhe nga burime të tjera. Rrjedhimisht ky vendim nuk është në kundërshtim me nenin 118/1 të Kushtetutës.

- Vendimi i mësipërm është në përputhje të plotë me nenin 118/2 të Kushtetutës, pasi ligji nr.8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” autorizon nxjerrjen e aktit nënligjor të llojit vendim nga Këshilli i Ministrave, për përcaktimin e kriterëve të cilësisë së lëndëve djegëse.

- Kufizimi i lirisë ekonomike nuk është vendosur nga aktet nënligjore VKM nr.147 apo vendimi objekt shqyrtimi, por nga ligji nr. 8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, në zbatim të të cilit kanë dalë këto vendime.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nuk ka shkelur Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), pasi neni 42 i kësaj marrëveshjeje parashikon mundësinë e vendosjes së kufizimeve të ngjashme me ato të bëra nga ligji nr. 8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

II

1. Lidhur me pretendimin e subjektit të interesuar se kërkuari nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese sipas objektit të kërkesës.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka interpretuar, në jurisprudencën e saj, kriteret kushtetuese për legjitimitimin e organizatave si subjekte që mund ta vënë atë në lëvizje (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9/2008, 41/2007, 35/2007, 11/2007, 9/2007). Shoqatat ose organizatat e tjera janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007). Ato kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak.

Gjykata Kushtetuese ka çmuar, se kuptimi mbi legjitimitimin duhet parë edhe në këndvështrimin e dallimit që ekziston ndërmjet pretendimit për cenim të së drejtës për veprimtari të lirë ekonomike (neni 11 i Kushtetutës) dhe pretendimit për antikushtetutshmëri të aktit nënligjor të kundërshtuar, në kuptim të rregullimit kushtetues të parashikuar nga neni 118 i Kushtetutës (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 25.07.2008).

Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.810, datë 28.10.2003. Anëtarët e shoqatës janë shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve në Shqipëri. Në statutin e shoqatës parashikohet, ndër të tjera, se qëllimi kryesor i shoqatës është “... përfaqësimi, dhe mbrojtja e

interesave të përbashkët të anëtarëve në kuadrin e zhvillimit të tregut të hidrkarbureve”. Kërkuesi është organizatë që mbron interesat ekonomike të anëtarëve të saj, të cilët janë persona juridikë që ushtrojnë aktivitet ekonomik në tregun e hidrokarbureve. Ai pretendon se vendimi, objekt i këtij gjykimi pranë Gjykatës Kushtetuese, krijon një diskriminim *in favorem*, në favor, të produktit Diezel D1 i prodhuar nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kundrejt atij të importuar nga anëtarët e kërkuesit. Gjithashtu, kërkuesi pretendon se vendimi objekt shqyrtimi, dëmton interesat ekonomike të anëtarëve të tij nëpërmjet krijimit të një monopoli të përkohshëm duke lejuar vetëm tregtimin e lëndës djegëse Diezel D2 të prodhuar nga shoqëria ARMO sh.a. Për këto arsye vendimi nr.52, datë 14.01.2009 i Këshillit të Ministrave ndërhyrës drejtpërdrejt në fushën e aktivitetit ekonomik të anëtarëve të kërkuesit, duke karakterizuar kështu lidhjen e drejtpërdrejtë me lirinë e veprimtarisë ekonomike të anëtarëve të kësaj shoqate.

2. Lidhur me kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit objekt shqyrtimi.

Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit objekt shqyrtimi. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, subjekti që kërkon pezullimin e një akti duhet të provojë prekjen e interesave shtetërorë, shoqërore ose të individëve si dhe pasojat e pariparueshme që do të sillte zbatimi i aktit. Gjykata nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e cenimit të interesave shtetërorë, shoqërore ose të individëve si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtij vendimi. Për këtë arsye Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të vendimit nr.52, datë 14.01.2009 të Këshillit të Ministrave.

3. Lidhur me pretendimin se vendimi objekt shqyrtimi është në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës.

Kërkuesi pretendon se vendimi, objekt i këtij gjykimi, cenon parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, të drejtën e pronës, ekonominë e lirë të tregut dhe qarkullimin e lirë të mallrave, të mbrojtura nga neni 11 i Kushtetutës. Sipas kërkuesit, në këtë vendim parashikohet që vetëm lënda djegëse Diezel D2 e prodhuar nga shoqëria ARMO sh.a. në vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, mund të tregtohet pas datës 1 janar 2009 deri në datën 31 dhjetor 2009. Kërkuesi pretendon gjithashtu, se vendimi objekt shqyrtimi cenon këtë parim, pasi krijon një diskriminim në favor të produktit vendas të prodhuar nga shoqëria ARMO përsa i përket sasisë së sqfurit të lejuar në lëndët djegëse që do të tregtohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga data 1 janar 2009 deri në datën 1 janar 2012.

Gjykata e ka sqaruar gjerësisht konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës. Sipas saj, kjo liri nënkupton kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve. Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës, lirinë e qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave pa asnjë kufizim, se individi ka të drejtë të punojë, të prodhojë, të konsumojë dhe të investojë në çdo mënyrë që i pëlqen dhe kjo liri duhet të mbrohet nga shteti. Liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete shumë të drejta dhe liri, si: liria e biznesit ose aftësia për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, liria e tregtisë ose mungesa e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, liria monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, liria fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende të lirë nga ndërhyrja e shtetit, liria e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, liria financiare dhe pavarësia nga kontrolli shtetëror, liria e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.03.2008).

Gjykata është shprehur gjithashtu, se liria e veprimtarisë ekonomike përmban edhe detyrimin e shtetit që, nëpërmjet ligjvënësit, të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie. Ky detyrim

për rregullim i ligjvënësist shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator që ka si qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet, që natyrshëm mund t'i mbart me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike.

Gjykata ka sqaruar edhe kriteret në bazë të të cilave shteti mund të ndërhyjë për të rregulluar ushtrimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, sipas Kushtetutës. Ajo është shprehur se, nisur nga struktura e Kushtetutës, e veçanta e nenit 11, paragrafi 3 është se ai nuk është parashikuar në grupin e të drejtave dhe lirive të tjera, por në pjesën ku parashikohen parimet themelore mbi të cilat mbështetet organizimi dhe funksionimi i shtetit. Kushtetutbërësi ka preferuar ta konsiderojë lirinë e veprimtarisë ekonomike së pari, si parim bazë të sistemit ekonomik të Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në standardet e interpretimit të shprehura më sipër, Gjykata vlerëson fillimisht ekzistencën ose jo të një kufizimi nga ana e vendimit objekt shqyrtimi. Më pas, Gjykata vlerëson nëse kufizimi i pretenduar është bërë sipas kriterëve të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë.

Kushtetuta e Shqipërisë parashikon se kufizimet e lirisë ekonomike mund të bëhen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar duke lejuar tregtimin e të njëjtit produkt me sasi të ndryshme squfuri, duke lejuar tregtimin e një produkti nga shoqëria ARMO të ndaluar për operatorët e tjerë dhe, duke u imponuar subjekteve tregtare që janë anëtare të kërkuarit dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, të pajisura me “leje tregtimi të llojit A”, blerjen e produktit Diezel D2 pranë një operatori të vetëm, nëse duan që këtë produkt të vazhdojnë të shesin, krijon në treg një monopol në favor të shoqërisë ARMO sh.a. dhe për pasojë cenon lirinë e importimit dhe eksportimit të mallrave dhe shërbimeve, duke kufizuar kështu lirinë e tyre ekonomike.

Siç është theksuar në mënyrë konstante nga Gjykata Kushtetuese (Shih vendimin nr.12, datë 28.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese) kufizimet e lirisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj. Gjykata e ka sqaruar edhe më parë kuptimin e shprehjes “vetëm me ligj”. Shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecion vetëm të Kuvendit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Në këtë përfundim, arrihet edhe duke iu referuar fjalës “vetëm” që përmendin nenet 11/3 të Kushtetutës. Përdorimi i kësaj fjale nuk është e rastit, por për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit. Gjykata Kushtetuese ka çmuar se shprehja “vetëm me ligj” referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cenon kompetencat e këtij organi (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 11.07.2006).

Sa më sipër Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se, vendimi objekt shqyrtimi vendos një kufizim të lirisë ekonomike, kufizim i cili në bazë të dispozitave kushtetuese mund të vendoset vetëm me ligj.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 11 të vendimit objekt shqyrtimi janë në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës..

4. Lidhur me pretendimin se vendimi objekt shqyrtimi, është në kundërshtim me marrëveshjet ndërkombëtare.

Kërkuar pretendon se vendimi objekt shqyrtimi, cenon parimin e ekonomisë së lirë të tregut dhe qarkullimin e lirë të mallrave, të mbrojtur nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, e zbatueshme në rastin konkret.

Në zbatim të nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve normative me marrëveshjet ndërkombëtare.

Gjykata Kushtetuese vlerëson, nëse kufizimi i lirisë ekonomike, i vendosur nga vendimi objekt shqyrtimi, është në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Në bazë të kësaj

marrëveshje e drejta e shtetit për të ndërhyrë në rregullimin e ushtrimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike njeh një kufizim të ri të përcaktuar në pikën 2 të nenit 33 të saj, i cili parashikon se, “Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen kufizime sasiore të reja për importet ose eksportet, apo masa të reja me efekt të njëjtë me to, dhe as nuk bëhen kufizime të mëtejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë”.

Në zbatim të dispozitës së mësipërme shteti mund të kufizojë ushtrimin e lirisë ekonomike për atë që nuk krijohet kufizime të mëtejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shqipërisë. Por edhe ky kufizim i kompetencës shtetërore gjen përjashtim në nenin 42 të kësaj marrëveshjeje i cili parashikon se “Kjo Marrëveshje nuk përjashton ndalimet apo kufizimet e importeve, eksporteve ose mallrave tranzit të justifikuar në bazë të moralit publik, politikave publike ose sigurisë publike; mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve; mbrojtjes së thesareve kombëtare me vlerë artistike, historike ose arkeologjike, ose mbrojtjes së pronësive intelektuale, industriale dhe tregtare, ose të rregullave lidhur me arin dhe argjendin. Megjithatë, ndalime ose kufizime të tilla nuk përbëjnë diskriminim arbitrar ose kufizim të tërthortë në tregtinë ndërmjet palëve”.

Gjykata vëren se legjislacioni i brendshëm shqiptar ndalon tregtimin e lëndës Diezel D2, ndërsa për lëndën Diezel D1 lejon tregtimin e saj në disa kushte cilësie të përcaktuara dhe të zbatueshme njëloj për të gjithë operatorët. Vendimi objekt shqyrtimi, përbën një përjashtim ndaj këtij ndalimi duke lejuar vetëm tregtimin e lëndës djegëse Diezel D2 të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto të nxjerrë nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe duke lejuar tregtimin e lëndës Diezel D1 të prodhuar nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në kushte cilësie më të favorshme se ajo e importuar. Për rrjedhojë, vendimi objekt shqyrtimi, nëpërmjet përjashtimit që krijon ndryshon legjislacionin shqiptar, duke krijuar një situatë ndalimi të importeve për një produkt dhe duke favorizuar prodhimet e brendshme për një produkt tjetër.

Gjykata vëren se vendimi objekt shqyrtimi, duke ndryshuar rregullat ligjore mbi importin e lëndës djegëse Diezel D2 dhe tregtimin e lëndës djegëse Diezel D1, krijon kufizim total për importet e lëndës Diezel D2 dhe vështirëson tregtimin e lëndës djegëse Diezel D1 edhe nëse këto lëndë importohen nga vendet anëtare të Komunitetit Europian, duke kufizuar kështu tregtinë ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shqipërisë.

Subjekti i interesuar pretendon se ky kufizim lejohet në zbatim të nenit 42 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi i kundërshtuar nuk është i marrë në zbatim të nenit 42 të sipërpërmendur, pasi subjekti i interesuar nuk paraqiti prova se vendimi objekt shqyrtimi është marrë në zbatim të rasteve të parashikuara në pjesën e parë të këtij neni dhe as mundi të argumentojë që ky vendim nuk përbën diskriminim arbitrar në tregtinë ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shqipërisë.

Për sa më sipër, vendimi nr.52, datë 14.01.2009 i Këshillit të Ministrave është në kundërshtim me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, konkretisht me nenet 33 dhe 42 të saj. Si rrjedhojë Gjykata Kushtetuese vlerëson se, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 11 të vendimit të mësipërm duhen shfuqizuar.

5. Lidhur me pretendimin se vendimi objekt shqyrtimi, është në kundërshtim me nenin 118 të Kushtetutës.

Kërkuuesi pretendon se vendimi i Këshillit të Ministrave, i kundërshtuar, nuk respekton kriteret e nenit 118/1 të Kushtetutës sipas të cilit, aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e përcaktuara me Kushtetutë; dhe nenit 118/2, sipas të cilit, ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si edhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. Sipas kërkuarit, nenet 8 dhe 9 të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në asnjë pjesë të tyre nuk i japin kompetencë

Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte nënligjore për përcaktimin e subjekteve tregtare të privileguara dhe atyre të diskriminuara. Kërkuesi pretendon gjithashtu se, vendimi objekt shqyrtimi, ka tejkaluar delegimin legjislativ të bërë nga neni 10, pika 5, e ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.

Gjykata, më sipër, lidhur me pretendimin për kufizim të veprimtarisë së lirisë ekonomike është shprehur se kufizimi i kësaj lirie është bërë nga vendimi nr.52 datë 14.01.2009 i Këshillit të Ministrave, në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës që parashikon se këto kufizime mund të bëhen vetëm me ligj. Bazuar mbi këtë qëndrim Gjykata e çmon të mbështetur legjitimitimin e kërkuesit për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së vendimit objekt i shqyrtimit kushtetues, në lidhje me kriteret e nenit 118 të Kushtetutës.

Neni 118/2 i Kushtetutës parashikon: “Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.”

Gjykata e vlerëson të bazuar pretendimin e kërkuesit për cenim të nenit 118/1,2 të Kushtetutës, me arsyetimin se ligji nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nuk parashikon asnjë delegim legjislativ për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe as e përcakton Këshillin e Ministrave si organin kompetent.

Neni 10, pika 5 e ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” parashikon se “Prodhuesit, importuesit, eksportuesit, transportuesit dhe tregtuesit e lëndëve djegëse detyrohen t’i prodhojnë, t’i importojnë dhe t’i tregtojnë ato në përputhje me kërkesat e cilësisë, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit”.

Pretendimi se është shkelur neni 118/1,2 i Kushtetutës, pasi vendimi i kundërshtuar është marrë në tejkalim të kompetencave të deleguara nga neni 10, pika 5 e ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” vlerësohet nga Gjykata si i drejtë, pasi vendimi objekt shqyrtimi, në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9 nuk përmban dispozita mbi cilësinë e lëndëve djegëse. Këto dispozita lejojnë përdorimin e një produkti dhe përcaktojnë kushtet e tregtimit të tij. Rrjedhimisht, këto pika të vendimit të mësipërm të Këshillit të Ministrave tejkalojnë delegimin legjislativ të bërë nga pika 5 e nenit 10 të ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.

Gjykata Kushtetuese vëren, në plotësim të interpretimit të kryer në vendimin nr.12, datë 28.04.2009 të saj, se nëse pikat 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9 të vendimit objekt shqyrtimi do të kishin një lidhje të ngushtë me objektin e delegimit, atëherë kushtetutshmëria e tyre duhet pranuar në cilësinë e aksesorit, ose ndihmësit të domosdoshëm të dispozitave kryesore të marra në zbatim të një ligji që vendos kufizimin e një të drejte kushtetuese. Nga vetë karakteri i tyre aksesori, ose ndihmës, këto dispozita ndjekin fatin e dispozitave kryesore, ndihmëse të të cilave ato janë, dhe nuk mund të zbatohen në mungesë të tyre ose jashtë qëllimeve të tyre. Për këtë arsye, një dispozitë aksesore, e cila mund të zbatohet në mënyrë të pavarur nga dispozita kryesore, objekt i delegimit, nuk mund të ketë karakterin ndihmës.

Gjykata vëren se vetëm pikat 7 dhe 11 të vendimit të kundërshtuar, edhe pse nuk përcaktojnë kriteret e cilësisë së lëndëve djegëse, kanë karakterin e dispozitës ndihmëse pasi garantojnë zbatimin dhe respektimin e pikës 6 të vendimit që hyn në kuadrin e objektit të delegimit të nenit 10, pika 5 e ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pikat 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9 të vendimit objekt shqyrtimi, nuk kanë lidhje me delegimin ligjor të pikës 5 të nenit 10 të ligjit nr.8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, e cila i mundëson Këshillit të Ministrave përcaktimin e cilësisë së lëndëve djegëse të tregtuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe me nenet 8 dhe 9 të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Kërkuesi hoqi dorë nga pretendimi për shfuqizimin e pikës 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009, objekt i këtij shqyrtimi kushtetues, prandaj Gjykata nuk e shqyrtoi këtë pretendim.

Si përfundim, në vijim të arsytimit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009 cenon parimet e sanksionuara nga nenet 11 dhe 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 33 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Komunitetin European.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja “c”, 132 dhe 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe neneve 49 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të pikave 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009 “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diesel), të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë”.

- Rrëzimin e kërkesës për kerkimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Admir Thanza, Sokol Berberi.

MENDIM PARALEL

Duke mbështetur pjesërisht shumicën në vendimin për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009 “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diesel) të prodhuar nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe të tregtuar për automjete rrugore e gjeneratorë” (VKM nr.52), vetëm për nenin 118 pika 2, nuk pajtohem me të në argumentet e përdorura për çështjet e tjera si më poshtë:

1. Në vendimin e saj shumica arrin në përfundimin se VKM nr.52, veç sa sipër, vjen në kundërshtim edhe me nenin 11 të Kushtetutës, si dhe me nenin 33 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Komunitetin European (MSA). Sipas shumicës VKM nr.52 “duke lejuar tregtimin e një produkti nga shoqëria “ARMO”, të ndaluar për operatorët e tjerë, dhe duke u imponuar subjekteve tregtare që janë anëtare të Shoqatës së Shoqërive të Hidrokarbureve që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, të pajisura me leje tregtimi të llojit A, blerjen e produktit Diezel D2 vetëm pranë një operatori të vetëm, nëse duan që këtë produkt të vazhdojnë ta shesin, krijon një monopol në treg në favor të shoqërisë “ARMO” dhe për pasojë cenon lirinë e importimit dhe eksportimit të mallrave dhe shërbimeve, duke kufizuar kështu lirinë e tyre ekonomike”. Dhe, meqenëse ky kufizim nuk është bërë me ligj, shumica e konsideron VKM nr.52 si të papajtueshëm me nenin 11 të Kushtetutës.

2. Më tej shumica vlerëson se VKM nr.52 është i papajtueshëm edhe me nenin 33 të

MSA sipas të cilës “që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, nuk vendosen kufizime sasiore të reja për importet ose eksportet, apo masa të reja me efekt të njëjtë me to dhe as nuk bëhen kufizime të mëtejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë”. Shumica vëren se VKM nr.52, krijon kufizim total për importet e produktit Diezel D2 edhe nëse këto importe kryhen nga vendet anëtare të Komunitetit Europian, duke kufizuar kështu tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.

3. Në kundërshtim me sa më sipër, ne mendojmë se nuk është VKM nr.52 që nëpërmjet normave të tij ka bërë një kufizim të lirisë ekonomike. Përkundrazi, ky kufizim është bërë më parë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzen dhe diesel” (VKM nr.147). Në këtë vendim, ndër të tjera thuhet se në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga data 1 janar 2009 do të lejohet për përdorim në automjetet rrugore dhe gjeneratorët, vetëm tregtimi i lëndës djegëse diesel, e cila plotëson kërkesat e standardit shqiptar S SH EN 590 ose të standardeve të tjera të barasvlefshme me të (Diezel D1).

4. VKM nr.52 nuk bën gjë tjetër veçse lejon një përjashtim nga rregullat e vendosura më sipër vetëm për shoqërinë “ARMO” dhe vetëm për tregtimin e lëndës djegëse të prodhuar në rafineritë e vendit nga rafinimi i naftës bruto, të nxjerrë nga vendburimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky përjashtim nuk kufizon lirinë ekonomike për shoqëritë e tjera interesat e të cilave mbron kërkuesi, sepse këtë kufizim, siç u përmend dhe më sipër, e ka bërë VKM nr.147. “Pozitën dominuese” në treg për një shoqëri apo një tjetër e lejon ligji nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (shih nenet 8 e vijuesat) dhe vetëm konstatimi i saj, në rastin e Shoqërisë “ARMO”, nuk mund të përbëjë kufizim të lirisë ekonomike për të tretët. Edhe në qoftë se, në mënyrë hipotetike do të pranim se ka një kufizim të lirisë ekonomike për shoqëritë e përfaqësuara nga kërkuesi, ky kufizim në rastin konkret është i përkohshëm dhe bëhet për arsye të rëndësishme publike që lidhen, veç të tjerash, edhe me shfrytëzimin racional të burimeve natyrore të vendit (neni 59 i Kushtetutës), mjafton që të kishte një autorizim nga ligjvënësi në ligjin nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Për këto arsye, argumentet e përdorura nga shumica për të arritur në përfundimin se VKM nr.52 kufizon lirinë ekonomike dhe për rrjedhojë ai është i papajtueshëm me nenin 11 të Kushtetutës janë të pabazuara.

5. Për të njëjtat argumente, i pabazuar është vendimi i shumicës edhe kur konstaton papajtueshmërinë e VKM nr.52 me nenin 33 të MSA. Kjo e fundit në nenin 42 nuk përjashton vendosjen e ndalimeve apo kufizimeve të importeve, eksporteve ose mallrave tranzit të justifikuara në bazë të moralit publik, politikave publike ose sigurisë publike.

Për sa më sipër, jemi të mendimit se VKM nr.52 është i papajtueshëm vetëm me nenin 118 pika 2 të Kushtetutës për arsye se në asnjë nga nenet e tij, ligji nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nuk autorizon nxjerrjen e akteve nënligjore dhe as nuk përcakton organin kompetent. Për rrjedhojë, referimi që bën VKM nr.52 në këtë ligj është i pabazuar dhe i paautorizuar prej ligjvënësit. Ndërsa referimi i VKM 52 në ligjin nr.8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, ashtu si përmendet dhe në vendim, është i pabazuar, sepse VKM nr.52 nuk përmban dispozita mbi cilësinë e lëndëve djegëse.

Anëtarë: Admir Thanza, Vladimir Kristo (kryetar)